



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 475/3 prot.

Tiranë, më 22.10.2020

VENDIM
Nr.131, datë 22.10.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 43, DATË 3.5.2019

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 43, datë 3.5.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*,

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 95, datë 03.12.2018 *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje dhe në institucionin e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në institucionin Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Paralajmërues Nr. 43, datë 3.5.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje, me shkresën nr. 79/1 prot., datë 11.06.2020, *“Kthim përgjigje shkresës suaj nr. 475 prot., datë 29.5.2020”*, ka informuar Komisionerin në lidhje

me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues dhe në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga institucioni, arrij në përfundimin se, nga ana e institucionit të mbikëqyrur, Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje, janë zbatuar plotësisht detyrat e lëna në vendim. Konkretisht:

1. Sipas akteve të administruara në dosjen e verifikimit rezulton se, formularët e përshkrimit të punës janë dërguar për të marrë miratimin zyrtar të Departamentit të Administratës Publike.
2. Njësia përgjegjëse ka marrë masat dhe në zbatim të rekomandimeve të lëna, procedurat e kryera në formë elektronike i ka materializuar edhe në formë shkresore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 43, datë 3.5.2019, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Lushnje dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Lushnje, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 43, datë 3.5.2019.
3. Për këtë vendim të njoftohet Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Lushnje, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha